



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTARI TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T.

ZEDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Znj. BELINDA BALLUKU

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Znj. ROMINA KUKO

Miratur me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 66, datë 12/07/2022

Kryetar i Bashkisë

Z. ERION VELIAJ

DOKUMENTI I RISHIKIMIT TË

PLANIT TËPËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA TIRANË

Miratur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 02, datë 27/07/2022

DPPZHT: **Znj. FRIDA PASHAKO**

PËRGATITI

AUTOR:

Drejtoria e Planifikimit të Territorit,
Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit,
Bashkia Tiranë.

UDHËHEQËS TË PROCESIT:

Frida Pashako, Drejtor i Përgjithshëm

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Anisa Mançe, Drejtor

Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

GRUPI I PUNËS:

Enton Punavija, Drejtor

Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike

Edian Meçe, Përgjegjës

Sektori i Planifikimit të Territorit për Rindërtim, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Fatmir Hoxha, Përgjegjës

Sektori i Projektimit Inxhinierik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Eva Hoxha, Përgjegjës

Sektori i Planeve të Detajuara Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Gentian Nechvatal, Përgjegjës

Sektori i Infrastrukturës së Trafikut, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike

Soviela Shehu, Specialist

Sektori i Planeve të Përgjithshme Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Iva Tavanzhiu, Specialist

Sektori i Planeve të Përgjithshme Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit



Elda Maçi, Specialist

Sektori i Planeve të Detajuara Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit



Alket Hakiraj, Specialist

Sektori i Planeve të Detajuara Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit



Enkelejda Beja, Specialist

Sektori i Planeve të Detajuara Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit



TABELA E PËRMBAJTJES

KREU I.....	5
NDRYSHIME NË RREGULLOREN VENDORE TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR	5
KREU II	9
NDRYSHIME NË ‘HARTËN E NJËSIVE STRUKTUREORE’, NË ‘HARTËN E PËRDORIMIT TË TOKËS’, DHE NË TABELAT PARAMETRIKE TË NJËSIVE STRUKTUREORE PËR INTEGRIMIN E PLANEVE TË DETYRUARA VENDORE (PDyV) NË PLANIN E PËRGJITHSHËM VENDOR.....	9
KREU III.....	24
NDRYSHIME NË ‘HARTËN E PËRDORIMIT TË TOKËS’, NË ‘HARTËN E RRJETIT RRUGOR TË PROPOZUAR SIPAS KATEGORIVE TË KODIT RRUGOR’ DHE NË TABELAT PARAMETRIKE TË NJËSIVE STRUKTUREORE PËR SHKAK TË MOSPËRPUTHJEVE TË PËRCAKTIMEVE NË DOKUMENTIN E PLANIFIKIMIT ME GJENDJEN FAKTIKE TË ZHVILLIMEVE NË TERRITOR.....	24
KREU IV	50
SAKTËSIME TË KOORDINATAVE TË POLIGONEVE, PA NDRYSHIME TË PËRQINDJEVE SË PËRDORIMIT TË TOKËS, BRENDA NJËSIVE STRUKTUREORE ..	50
KREU V.....	52
NDRYSHIME NË ‘HARTËN E NJËSIVE STRUKTUREORE’, NË ‘HARTËN E PËRDORIMIT TË TOKËS’ DHE NË TABELAT PARAMETRIKE TË NJËSIVE STRUKTUREORE	52



KREU I

NDRYSHIME NË RREGULLOREN VENDORE TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1 DATË, 14.04.2017
DHE VENDIMIN NR. 01, DATË 23.10.2019 TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
TERRITORIT, NË “RREGULLOREN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
TË BASHKISË TIRANË”

Në “Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë” (e ndryshuar), bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

- **Neni 1**
Në nenin 5, pika 1, bëhen këto ndryshime:
Gërma “r” bëhet gërma “q”.
- **Neni 2**
Në nenin 15, pika 4, gërma “P”, fjalët “N - Nënkatëgorigtë e kategorisë bazë (N) natyrë”, zëvendësohen me fjalët “B – Nënkatëgorigtë e kategorisë bazë (B) bujqësi”.
- **Neni 3**
Në nenin 23, shtohet pika 3, me përmbajtje si më poshtë:
“3. Në rastet kur kategoria e përdorimit “IS” – Institucione, shtrihet edhe në njësi të cilat si pasojë e përdorimeve kryesore të lejuara të tyre nuk kanë kushte zhvillimore në pasaportat e tyre, atëherë për këto njësi, lejohet të zhvillohen struktura me përdorim “IS” me intensitet maksimal 0.5 për parcelë apo grup parcelë, dhe lartësi maksimale 3 kate në rastet e konsolidimit urban”.
- **Neni 4**
Në nenin 31, pika 1, gërma “e”, pas fjalëve “... së ndërtimit të njësisë strukturore”, shtohen fjalët “...përveç rasteve të përdorimit të tokës së propozuar IE dhe IE+S”.
- **Neni 5**
Në nenin 32, pika 10, pas fjalëve “...30% të sipërfaqes totale të këtyre njësive”, shtohen fjalët “...përveç rasteve të përdorimit të tokës së propozuar IE dhe IE+S”.
- **Neni 6**
Në nenin 35, pika 3, pas fjalëve “...ristrukturim dhe mbushje urbane, apo konservim dhe rristrukturim” shtohen fjalët “...dhe kombinime të tjera”.
- **Neni 7**
Në nenin 39, pika 6, pas fjalëve “...hierarkia e propozuar...”, shtohen fjalët “...dhe/ose kur është realizuar mbi 80% e intensitetit të propozuar.”



- **Neni 8**
Në nenin 44, pika 1, gërma "a", fjalët "...intensitetin e ndërtimit 0.3," bëhen "...intensitetin e ndërtimit 0.03,".
- **Neni 9**
Në nenin 44, pika 10, pas fjalëve "...produkteve bujqësore" shtohen fjalët "...magazinat bujqësore dhe/ose blegtorale".
- **Neni 10**
Në nenin 45, pika 3, pas fjalëve "...sipas kushteve të mëposhtme", shtohen fjalët "...dhe për rastet kur njësitë strukturore nuk kanë kushte zhvillimore në pasaportat e tyre".
- **Neni 11**
Në nenin 45, pika 3, gërma "b", pas fjalëve "...me intensitet 0.1" shtohen fjalët "...dhe lartësi maksimale 1 kat".
- **Neni 12**
Në nenin 45, pika 3, gërma "c", pas fjalëve "...me intensitet 0.2" shtohen fjalët "...dhe lartësi maksimale 2 kat".
- **Neni 13**
Në nenin 45, pika 3, gërma "d", pas fjalëve "...me intensitet 0.15" shtohen fjalët "...dhe lartësi maksimale 2 kat".
- **Neni 14**
Në nenin 45, pika 3, gërma "e", pas fjalëve "...me intensitet 0.06" shtohen fjalët "...dhe lartësi maksimale 1 kat".
- **Neni 15**
Në nenin 46, pika 2, fjalët "kushtet sipas nenit për KSHT" do të zëvendësohen me fjalët "KSHT deri në 30% të parcelës apo grup parcelave për zhvillim".
- **Neni 16**
Në nenin 46, pika 3, fjalët "deri në plotësimin e kushteve të zhvillimit sipas pikës 2 të këtij neni" do të zëvendësohen me fjalët "deri në masën 30% të parcelës apo grup parcelave për zhvillim".
- **Neni 17**
Në nenin 47, pika 2, fjalët "kategoria e përdorimit urban" do të zëvendësohen me fjalët "kategoria e përdorimit banim" dhe fjalët "vetëm në zonat urbane" do të zëvendësohen me fjalët "vetëm në territoret me përdorim banim".
- **Neni 18**
Në nenin 47, pika 6 shfuqizohet.
- **Neni 19**
Në nenin 48, pika 6, pas fjalëve "...industri dhe ekonomi" shtohen fjalët "...dhe industri dhe ekonomi + shërbime".



- **Neni 20**
Në nenin 48, në fund të pikës 11, shtohet fjalia: *“Përjashtim nga parashikimet e kësaj pike përbëjnë verandat e mbuluara, të cilat janë subjekt për llogaritjen e parametrave të zhvillimit.”*
- **Neni 21**
Në nenin 50, pika 4, hiqet fjalia *“Përjashtim nga kushtet e kësaj pike dhe këtij neni bëjnë rastet e rizhvillimit të strukturave shumë-familjare sipas parashikimit të nënit 48/13”*.
- **Neni 22**
Në nenin 50, shtohet pika 5, me përmbajtje si më poshtë:
“5. Përjashtim nga kushtet sipas këtij neni bëjnë rastet e rizhvillimit të strukturave shumë-familjare sipas parashikimit të nënit 48, pika 13 e kësaj rregullore”.
- **Neni 23**
Në nenin 50, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë:
“6. Përjashtim nga kushtet sipas pikës 4 të këtij neni bëjnë rastet e zhvillimit që japin kontribut për rrugë dhe trotuare në masën më shumë se 45% të parcelës apo grup parcelave për zhvillim, për njësitë strukturore të cilat i nënshtrohen hartimit të PDV”.
- **Neni 24**
Në nenin 51, pika 7, pas fjalëve *“...në vijim të pikës 6 të këtij neni”* shtohen fjalët *“...me përjashtim të nën-njësive që nuk janë subjekt hartimi PDV”*.
- **Neni 25**
Në nenin 51, pika 8, gërma “b”, fjalët *“parcela ka mbi 50% e sipërfaqes së saj”* zëvendësohen me fjalët *“parcela apo grup parcelat për zhvillim kanë mbi 50% të sipërfaqes së tyre”*.
- **Neni 26**
Në nenin 51, pika 8, gërma “c” shfuqizohet.
- **Neni 27**
Në nenin 51, pika 9, gërma “b”, fjalët *“parcela ka mbi 60% e sipërfaqes së saj”* zëvendësohen me fjalët *“parcela apo grup parcelat për zhvillim kanë mbi 50% të sipërfaqes së tyre”*.
- **Neni 28**
Në nenin 51, pika 10, gërma “d”, pas fjalëve *“Të gjitha përdorimet IE...”*, shtohen fjalët *“...apo IE+S”*.
- **Neni 29**
Në nenin 53, pika 3, shfuqizohet.
- **Neni 30**
Në nenin 53, pika 4, riformulohet *“Nuk lejohet që elementet arkitektonike të fasadave, të cilat nuk përbëjnë sipërfaqe të shfrytëzueshme, të tejkalojnë vijën e ndërtimit në lartësi më të ulët se 5m nga kuota e trotuarit dhe 0.5m nga faqja e strukturës”*.



- **Neni 31**
Në nenin 54, pika 7, gërma “b”, pas fjalëve “...të përdorimit IE”, shtohen fjalët “...apo IE+S”.
- **Neni 32**
Në nenin 54, pika 8, riformulohet “Për të gjitha strukturat me çati, lartësia e ndërtimit mbi tokë, e shprehur në numër katesh, është e barabartë me shumën e kateve mbi tokë, përfshirë katin ose gjysëm katin nën çati. Lartësia e strukturës e ndërtimit mbi tokë, e shprehur në metra, do të matet me lartësinë maksimale të strukturës përfshirë katin apo gjysëm katin nën çati të shfrytëzueshëm, ose deri në pikën më të lartë të fundit të parapetit rrethues të mbulesës së sheshtë të objektit”.
Në fund të kësaj pike shtohen fjalët: “Çatitë e pa shfrytëzueshme deri në lartësinë 2.2m nuk llogariten në lartësinë maksimale të objektit”.
- **Neni 33**
Në nenin 54, pika 9, pas fjalëve “...distancave nga strukturat dhe...” shtohet “.../ose...”.
- **Neni 34**
Në nenin 55, pika 3, pas fjalëve “Pa rënë ndesh me pikën 6...” shtohet “...dhe 7” dhe në fund të fjalisë pas fjalëve “...dhe respektimit të pikës 6...” shtohen fjalët “...dhe 7”
- **Neni 35**
Në nenin 55, pika 4, fjalët “ $Nr.kate + 1 < Nr.kate PPV/2$ ”, zëvendësohen me “ $Nr.kate + 1 \leq Nr.kate PPV/2$ ”.
- **Neni 36**
Në nenin 56, pas pikës 2.1, shtohet pika 2.1.1 me formulimin si më poshtë: “Në territorin urban struktura e re e propozuar për zhvillim të mos krijojë faqe të re kallkan për rastet e zhvillimit të banesave një familjare në respektim të nenit 46 të kësaj rregulloreje.”
- **Neni 37**
Neni 57, Pika 11, shfuqizohet.
- **Neni 38**
Neni 67, Pika 3, shfuqizohet.
- **Neni 39**
Në nenin 79, pika 5, riformulohet si më poshtë: “Ky plan dhe kjo rregullore përcaktojnë kushtet për realizimin e ardhshëm të projekteve teknike të rrjeteve rrugore të përcaktuara nga PPV.”
- **Neni 40**
Në nenin 79, pika 13, fjalët “Sipërfaqet e gjelbra” zëvendësohen me fjalët “Koeficientin e Shfrytëzimit të Territorit (KSHP)”.



KREU II

NDRYSHIME NË ‘HARTËN E NJËSIVE STRUKTURE’, NË ‘HARTËN E PËRDORIMIT TË TOKËS’, DHE NË TABELAT PARAMETRIKE TË NJËSIVE STRUKTURE PËR INTEGRIMIN E PLANEVE TË DETYRUARA VENDORE (PDyV) NË PLANIN E PËRGJITHSHËM VENDOR

Në *“Hartën e njësive strukturore”, “Hartën e përdorimit të tokës” dhe në tabelat parametrike të njësive strukturore*, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon.

Këto ndryshime bazohen në Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019 *“Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”* dhe në Vendimin nr.887, datë 24.12.2019 (e ndryshuar) *“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit / ndërtimit në rastet e fatkeqësisë natyrore”*.

Paraqitja grafike e ndryshimeve do të bëhet sipas imazheve në *Shtojcën I* dhe koordinatave në *Shtojcën V* të këtij dokumenti.

i. Zona e rindërtimit Baldushk

- a) Bazuar në VKM nr. 82, datë 31.1.2020 *“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë administrative Baldushk, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”*, ndryshuar me VKM nr.119, datë 2.3.2022 *“Për një ndryshim në vendimin nr.82, datë 31.1.2020 të Këshillit të Ministrave ‘Për shpalljen e zonës së re për zhvillim nënjësinë administrative Baldushk, Bashkia Tiranë dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese’”*, përcaktohet zona për rindërtim Baldushk si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës 1, njësia administrative Baldushk, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim, me sipërfaqe 24171.98 m².
- b) Krijimi i zonës së re për rindërtim, sjell ndryshime në njësitë kufitare të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor si njësitë strukturore BA/9, BA/39 dhe BA/44, të detajuara si më poshtë vijon.
- c) Treguesit e zhvillimit dhe kategorië e përdorimit të tokës për këtë zonë përcaktohen në Planin e Detyruar Vendor (PDyV).

ii. Zona e rindërtimit Pezë

- a) Bazuar në VKM nr. 84, datë 31.1.2020 *“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Pezë, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”*, ndryshuar me VKM nr.978, datë 2.12.2020 *‘Për një ndryshim në vendimin nr. 84, datë 31.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për rrizhvillim nënjësinë administrative Pezë, Bashkia Tiranë dhe caktimin e Bashkisë*



Tiranë si njësi zbatuese”, përcaktohet zona për rindërtim Pezë, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës 1, njësia administrative Pezë, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim, me sipërfaqe 14860.46 m².

- b) Krijimi i zonës së re për rindërtim, sjell ndryshime në njësitë kufitare të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor si njësitë strukturore **PE/12 dhe PE/38**, të detajuara si më poshtë vijon.
- c) Treguesit e zhvillimit dhe kategorië e përdorimit të tokës për këtë zonë përcaktohen në Planin e Detyruar Vendor (PDyV).

iii. Zona e rindërtimit Ndroq

- a) Bazuar në VKM nr. 83, datë 31.1.2020 *“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Ndroq, Bashkia Tiranë dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese*”, ndryshuar me vendimin nr. 198, datë 6.4.2022 *‘Për një ndryshim në vendimin nr. 83, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Ndroq, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”*’, përcaktohet zona për rindërtim Ndroq, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës 1, njësia administrative Ndroq, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim, me sipërfaqe 35433.76 m².
- b) Krijimi i zonës së re për rindërtim, sjell ndryshime në njësitë kufitare të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor si njësitë strukturore **ND/53, ND/61, ND/143**, të detajuara si më poshtë vijon.
- c) Treguesit e zhvillimit dhe kategorië e përdorimit të tokës për këtë zonë përcaktohen në Planin e Detyruar Vendor (PDyV).

iv. Zona e rindërtimit Vaqarr

- a) Bazuar në VKM Nr. 85, datë 31.1.2020 *“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese*”, përcaktohet zona për rindërtim Vaqarr, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës 1, Njësia administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim, me sipërfaqe 25309.93 m².
- b) Krijimi i zonës së re për rindërtim, sjell ndryshime në njësitë kufitare të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor si njësitë strukturore **VA/46 dhe VA/79**, të detajuara si më poshtë vijon.
- c) Treguesit e zhvillimit dhe kategorië e përdorimit të tokës për këtë zonë përcaktohen në Planin e Detyruar Vendor (PDyV).



v. Zona e rindërtimit Zall-Herr

- a) Bazuar në VKM nr. 86, datë 31.1.2020 *“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Zall-Herr, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”*, ndryshuar me vendimin nr.120, datë 2.3.2022 *‘Për një ndryshim në vendimin nr. 86, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Zall-Herr, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”*”, përcaktohet zona për rindërtim Zall-Herr, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës 1, njësia administrative Zall-Herr, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim, me sipërfaqe 35351.30 m².
- b) Krijimi i zonës së re për rindërtim, sjell ndryshime në njësitë kufitare të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor si njësitë **ZH/10, ZH/45 dhe ZH/46**, të detajuara si më poshtë vijon.
- c) Treguesit e zhvillimit dhe kategoritë e përdorimit të tokës për këtë zonë përcaktohen në Planin e Detyruar Vendor (PDyV).

vi. Zona e rindërtimit Autotraktori

- a) Bazuar në VKM nr. 79, datë 31.1.2020 *“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, Njësia administrative 1, zona autotraktori, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”*, përcaktohet zona për rindërtim Autotraktori, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës autotraktori, njësia administrative 1, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim, me sipërfaqe 242073.52 m².
- b) Krijimi i zonës së re për rindërtim, përcakton të gjithë njësië strukturore **TR/148** si zonë për rindërtim.
- c) Treguesit e zhvillimit dhe kategoritë e përdorimit të tokës për këtë zonë përcaktohen në Planin e Detyruar Vendor (PDyV).

vii. Zona e rindërtimit Universiteti Bujqësor i Tiranës

- a) Bazuar në VKM nr. 81, datë 31.1.2020 *“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative 11, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”*, përcaktohet zona për rindërtim Universiteti Bujqësor i Tiranës, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës autotraktori, njësia administrative 11, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim, me sipërfaqe 449794.25 m².
- b) Krijimi i zonës së re për rindërtim, përcakton të gjithë njësinë strukturore **TR/452** si zonë për rindërtim.



- c) Treguesit e zhvillimit dhe kategoritë e përdorimit të tokës për këtë zonë përcaktohen në Planin e Detyruar Vendor (PDyV).

viii. Zona e rindërtimit 5 Maji

- a) Bazuar në VKM nr. 78, datë 31.1.2020 *“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësitë administrative 4 dhe 8, zona “5 Maji”, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”*, ndryshuar me vendimin nr.85, datë 9.2.2022 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 78, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave *“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësitë administrative 4 dhe 8, zona “5 Maji”, Bashkia Tiranë dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”*’, përcaktohet zona për rindërtim 5 Maji, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës “5 Maji”, njësitë administrative 4 dhe 8, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim, me sipërfaqe 363111.63 m².
- b) Krijimi i zonës së re për rindërtim, përcakton të gjithë njësitë strukturore TR/253 dhe TR/256 si zona për rindërtim dhe ndryshojnë pjesërisht njësitë strukturore të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor si njësitë TR/5, TR/124, TR/175, TR/176, TR/257, TR/255, TR/259, TR/260, TR/267, TR/310, TR/312, TR/311, TR/313, TR/466, TR/465, TR/470, TR/471, TR/522 dhe TR/584, të detajuara si më poshtë vijon.
- c) Treguesit e zhvillimit dhe kategoritë e përdorimit të tokës për këtë zonë përcaktohen në Planin e Detyruar Vendor (PDyV).

ix. Zona e rindërtimit ‘Kombinat’


- a) Bazuar në VKM nr. 80, datë 31.1.2020 *“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, njësia administrative 6, zona Kombinat, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”*, ndryshuar me vendimin nr. 112, datë 24.2.2021 *“Për një ndryshim në vendimin nr. 80, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative 6, zona Kombinat, Bashkia Tiranë dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese” dhe vendimin nr.86, datë 9.2.2022 ‘Për një ndryshim në vendimin nr.80, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative 6, zona Kombinat, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”’, të ndryshuar, përcaktohet zona për rindërtim Kombinat, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës “Kombinat”, njësia administrative 6, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim, me sipërfaqe 988699.76 m².*
- b) Krijimi i zonës së re për rindërtim, përcakton të gjithë njësitë strukturore TR/55, TR/56, TR/210, TR/211, TR/217, TR/219 dhe TR/221 si zona për rindërtim dhe



ndryshojnë pjesërisht njësitë strukturore të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor si njësitë KA/225, KA/226, KA/227, KA/228, KA/229, KA/230, KA/246, TR/11, TR/54, TR/57, TR/99, TR/209, TR/213, TR/214, TR/215, TR/218, TR/220, TR/222, TR/341, TR/342, VA/1 dhe VA/3, të detajuara si më poshtë vijon.

- c) Treguesit e zhvillimit dhe kategoritë e përdorimit të tokës për këtë zonë përcaktohen në Planin e Detyruar Vendor (PDyV)

Shënim: Në rastet e ndryshimit të kufirit të zonave të rindërtimit, për njësitë strukturore të cilat nuk do të jenë më pjesë e këtij kufiri, përdorimi i propozuar i tokës dhe treguesit e zhvillimit do të përcaktohen në PDV përkatëse. Për njësitë strukturore të cilat do të përfshihen në kufirin e zonave të rindërtimit, përdorimi i propozuar i tokës dhe treguesit e zhvillimit do të përcaktohen në PDyV.



i. Zona e rindërtimit Baldushk

1. Në njësinë strukturore BA/9

- a) *Kufiri i njësise strukturore ndryshon sipërfaqen nga 115904.85 m², në 95644.73 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Baldushk.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:75% / N:14% / B:9% / IN:3%, ndryshojnë në A:72% / N:16% / B:10% / IN:2%.*
- c) *Koordinatat e njësise strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

2. Në njësinë strukturore BA/39

- a) *Kufiri i njësise strukturore ndryshon sipërfaqen nga 582732.76 m², në 579146.83 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Baldushk.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga N:58% / B:23% / A:18% / V:1%, ndryshojnë në N:58% / B:23% / A:17% / V:1%.*
- c) *Kategoria e përdorimit të tokës "IN" (1%), është kategoria e pestë e njësise strukturore.*
- d) *Koordinatat e njësise strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

3. Në njësinë strukturore BA/44

- a) *Kufiri i njësise strukturore ndryshon sipërfaqen nga 2027428.44 m², në 2027102.50 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Baldushk.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga B:87% / A:9% / N:3% / IN:2%, ndryshojnë në B:86% / A:8% / N:3% / IN:2%.*
- c) *Kategoria e përdorimit të tokës "U" (1%), është kategoria e pestë e njësise strukturore.*
- d) *Koordinatat e njësise strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

ii. Zona e rindërtimit Pezë

1. Në njësinë strukturore PE/12

- a) *Kufiri i njësise strukturore ndryshon sipërfaqen nga 45446652.05 m², në 45443754.12 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Pezë.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga N:80% / B:17% / M:2%, ndryshojnë në N:81% / B:17% / M:2%.*
- c) *Kategoritë e përdorimit të tokës "A" dhe "IN", janë përkatësisht kategoria e katërt dhe e pestë, por të papërfillshme në % në raport me sipërfaqen e njësise strukturore.*
- d) *Koordinatat e njësise strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

2. Në njësinë strukturore PE/38

- a) *Kufiri i njësise strukturore ndryshon sipërfaqen nga 599061.76 m², në 587099.22 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Pezë.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga B:52% / A:43% / IN:4% / N:1%, ndryshojnë në B:49% / A:46% / IN:4% / N:1%.*



- c) Kategoria e përdorimit të tokës "AS+IS", është kategoria e pestë, por e papërfillshme në % në raport me sipërfaqen e njësisë strukturore.
- d) Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.

iii. Zona e rindërtimit Ndroq

1. Në njësinë strukturore ND/53

- a) Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 204997.90 m², në 123316.28 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Ndroq.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga B:65% / A:34% / IN:1%, ndryshojnë në B:79% / A:20% / IN:1%.
- c) Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.

2. Në njësinë strukturore ND/61

- a) Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 275232.75 m², në 266204.17 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Ndroq.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga B:53% / A:44% / IN:3%, ndryshojnë në B:54% / A:44% / IN:2%
- c) Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.

3. Në njësinë strukturore ND/143

- a) Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 481117.79 m², në 536431.18 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Ndroq.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga B:58% / A:39% / IN:3% / V:1%, ndryshojnë në B:57% / A:40% / IN:2% / V:1%.
- c) Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.

iv. Zona e rindërtimit Vaqarr

1. Në njësinë strukturore VA/46

- a) Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 656616.54 m², në 630733.06 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Vaqarr.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:86% / B:10% / IN:3% / IE:1%, ndryshojnë në A:78% / V:17% / B:3% / IN:2%.
- c) Kategoria e përdorimit të tokës "AS", është kategoria e pestë, por e papërfillshme në % në raport me sipërfaqen e njësisë strukturore.
- d) Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.

2. Në njësinë strukturore VA/79

- a) Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 1310737.51 m², në 1311311.05 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Vaqarr.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:41% / B:34% / IE+S:20% / IN:5%, ndryshojnë në A:41% / B:34% / IE+S:20% / IN:3% / N:2%.



c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

v. Zona e rindërtimit Zall-Herr

1. Në njësinë strukturore ZH/10

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 1784087.27 m², në 1784069.57 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Zallherr.*
- b) *Saktësohen poligonet e përdorimit të tokës, pa ndryshime në %.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

2. Në njësinë strukturore ZH/45

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 441794.99 m², në 436133.19 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Zallherr.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:51% / B:45% / AS:2% / IN:2%, ndryshojnë në A:51% / B:46% / AS:2% / IN:1%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

3. Në njësinë strukturore ZH/46

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 133003.75 m², në 103332.62 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Zallherr.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga B:84% / A:8% / U:5% / IN:3%, ndryshojnë në B:83% / A:7% / U:7% / IN:3%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

vi. Zona e rindërtimit 5 Maji

1. Në njësinë strukturore TR/5

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 27594.91 m², në 27226.81 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.*
- b) *Saktësohen poligonet e përdorimit të tokës, pa ndryshime në %.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

2. Në njësinë strukturore TR/124

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 51971.26 m², në 51287.21 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:89% / IN:5% / A+S:5%, ndryshojnë në A:90% / IN:5% / A+S:5%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

3. Në njësinë strukturore TR/175

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 38056.04 m², në 34365.81 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.*



- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga S+A+IE:85% / A:9% / IN:6%, ndryshojnë në S+A+IE:61% / A+S:28% / A:8% / IN:3%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*
4. Në njësinë strukturore TR/176
- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 35177.84 m², në 33736.96 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga S+A+IE:33% / A+S:27% / A:23% / AS:17%, ndryshojnë në A+S:58% / A:23% / AS:18% / IN:1%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*
5. Në njësinë strukturore TR/255
- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 34507.73 m², në 28164.43 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga IE+S:73% / A:22% / IN:5%, ndryshojnë në A+S:79% / A:20% / IN:1%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*
6. Në njësinë strukturore TR/257
- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 623578.54 m², në 556733.30 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga U:97% / A:2% / IN:1%, ndryshojnë në U:96% / A:3% / IN:1%.*
- c) *Kategoria e përdorimit "IE" është kategoria e katërt, por është e papërfillshme në % në raport me sipërfaqen e njësisë strukturore.*
- d) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*
7. Në njësinë strukturore TR/259
- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 62721.28 m², në 57913.04 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:97% / IN:3%, ndryshojnë në A:99% / IN:1%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*
8. Në njësinë strukturore TR/260
- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 61151.86 m², në 58243.06 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:97% / IN:2% / IE+S:1%, ndryshojnë në A:99% / IN:1%.*
- c) *Kategoria e përdorimit "IE+S" është kategoria e tretë, por është e papërfillshme në % në raport me sipërfaqen e njësisë strukturore.*
- d) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*



9. Në njësinë strukturore TR/267

- a) Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 48362.94 m², në 46170.13 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.
- b) Saktësohen poligonet e përdorimit të tokës, pa ndryshime në %.
- c) Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.

10. Në njësinë strukturore TR/310

- a) Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 57014.08 m², në 55359.11 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:96% / IN:4%, ndryshojnë në A:97% / IN:3%.
- c) Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.

11. Në njësinë strukturore TR/311

- a) Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 24259.62 m², në 23722.97 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:94% / IN:6%, ndryshojnë në A:95% / IN:5%.
- c) Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.

12. Në njësinë strukturore TR/312

- a) Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 159879.68 m², në 154251.27 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A+S:84% / A:14% / IN:2% / IS:1%, ndryshojnë në A+S:85% / A:13% / IN:1% / IS:1%.
- c) Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.

13. Në njësinë strukturore TR/313

- a) Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 48030.15 m², në 46377.85 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:76% / A+S:19% / IN:5%, ndryshojnë në A:76% / A+S:20% / IN:4%.
- c) Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.

14. Në njësinë strukturore TR/465

- a) Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 20536.33 m², në 19745.42 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A+S:50% / AS:39% / A:7% / IN:4%, ndryshojnë në A+S:49% / AS:40% / A:7% / IN:4%.
- c) Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.

15. Në njësinë strukturore TR/466

- a) Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 47620.14 m², në 46497.27 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.
- b) Saktësohen poligonet e përdorimit të tokës, pa ndryshime në %.



- c) Kategoritë e përdorimit “IE+S” është kategoritë e tretë, por është e papërfillshme në % në raport me sipërfaqen e njësive strukturore.
- d) Koordinatat e njësive strukturore paraqiten në Shtojcën V.

16. Në njësinë strukturore TR/470

- a) Kufiri i njësive strukturore ndryshon sipërfaqen nga 19754.28 m², në 18686.33 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:76% / A+S:19% / IN:4%, ndryshojnë në A:78% / A+S:19% / IN:3%.
- c) Koordinatat e njësive strukturore paraqiten në Shtojcën V.

17. Në njësinë strukturore TR/471

- a) Kufiri i njësive strukturore ndryshon sipërfaqen nga 20244.82 m², në 19289.79 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:95% / IN:5%, ndryshojnë në A:96% / IN:4%.
- c) Koordinatat e njësive strukturore paraqiten në Shtojcën V.

18. Në njësinë strukturore TR/522

- a) Kufiri i njësive strukturore ndryshon sipërfaqen nga 45721.98 m², në 42476.79 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:96% / IN:4%, ndryshojnë në A:97% / IN:3%.
- c) Koordinatat e njësive strukturore paraqiten në Shtojcën V.

19. Në njësinë strukturore TR/584

- a) Kufiri i njësive strukturore ndryshon sipërfaqen nga 30156.01 m², në 19761.25 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit 5 Maji.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:95% / IN:5%, ndryshojnë në A:97% / IN:3%.
- c) Koordinatat e njësive strukturore paraqiten në Shtojcën V.

vii. Zona e rindërtimit ‘Kombinat’

1. Në njësinë strukturore KA/225

- a) Kufiri i njësive strukturore ndryshon sipërfaqen nga 58401.20 m², në 51279.31 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.
- b) Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:88% / IN:11%, ndryshojnë në A:91% / IN:9%.
- c) Koordinatat e njësive strukturore paraqiten në Shtojcën V.

2. Në njësinë strukturore KA/226

- a) Kufiri i njësive strukturore ndryshon sipërfaqen nga 47380.22 m², në 55386.65 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.
- b) Saktësohen poligonet e përdorimit të tokës, pa ndryshime në %.



- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*
3. Në njësinë strukturore KA/227
- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 89760.58 m², në 88310.33 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:92% / IN:8%, ndryshojnë në A:93% / IN:7%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*
4. Në njësinë strukturore KA/228
- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 48438.17 m², në 41831.20 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:91% / IN:9%, ndryshojnë në A:93% / IN:7%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*
5. Në njësinë strukturore KA/229
- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 89759.26 m², në 85267.45 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:90% / IN:8% / IE+S:2%, ndryshojnë në A:82% / N:11% / IN:7%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*
6. Në njësinë strukturore KA/230
- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 95985.28 m², në 79726.02 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:89% / IN:8% / AS:3%, ndryshojnë në A:83% / N:7% / IN:6% / AS:4%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*
7. Në njësinë strukturore KA/246
- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 101862.35 m², në 109194.28 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:95% / IN:4% / N:1%, ndryshojnë në A:94% / IN:5% / N:1%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*
8. Në njësinë strukturore TR/11
- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 288075.94 m², në 265682.46 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Saktësohen poligonet e përdorimit të tokës, pa ndryshime në %.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*
9. Në njësinë strukturore TR/54
- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 34811.72 m², në 34110.23 m², si*



pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.

- b) *Saktësohen poligonet e përdorimit të tokës, pa ndryshime në %.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

10. Në njësinë strukturore TR/57

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 158616.20 m², në 130405.35 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga IE+S:37% / A:32% / S+IE+A:27% / IN:4%, ndryshojnë në IE+S:36% / A:30% / S+IE+A:30% / IN:4%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

11. Në njësinë strukturore TR/99

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 186400.40 m², në 185534.36 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Saktësohen poligonet e përdorimit të tokës, pa ndryshime në %.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

12. Në njësinë strukturore TR/209

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 296172.52 m², në 208395.11 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:81% / B:15% / IN:4%, ndryshojnë në A:77% / B:21% / IN:2%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

13. Në njësinë strukturore TR/213

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 680480.29 m², në 665672.85 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga B:52% / A:38% / N:8% / IN:1%, ndryshojnë në B:52% / A:38% / N:9% / IN:1%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

14. Në njësinë strukturore TR/214

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 52859.97 m², në 36695.52 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:88% / AS:6% / IN:5% / IS:1%, ndryshojnë në A:96 / IN:3% / IS:1%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

15. Në njësinë strukturore TR/215

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 40311.56 m², në 38576.78 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:81% / AS:13% / IN:6%, ndryshojnë në A:82% / AS:13% / IN:5%.*



c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

16. Në njësinë strukturore TR/218

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 399977.44 m², në 357045.64 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:85% / B:8% / N:5% / SH:1%, ndryshojnë në A:85% / B:9% / N:6%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

17. Në njësinë strukturore TR/220

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 437962.86 m², në 410784.66 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:96% / B:2% / IN:1% / IS:1%, ndryshojnë në A:96% / B:3% / IS:1%.*
- c) *Kategoria e përdorimit 'IN' është kategoria e katërt, por e papërfillshme në % në raport me sipërfaqen e njësisë strukturore.*
- d) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

18. Në njësinë strukturore TR/222

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 72056.90 m², në 63573.88 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga IE+S:62% / A:32% / IN:4% / B:3%, ndryshojnë në IE+S:68% / A:27% / IN:3% / B:2%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

19. Në njësinë strukturore TR/341

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 66839.58 m², në 16209.19 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:96% / IN:4%, ndryshojnë në A:98% / IN:2%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

20. Në njësinë strukturore TR/342

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 48943.74 m², në 23766.35 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A:96% / IN:4%, ndryshojnë në A:98% / IN:2%.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*

21. Në njësinë strukturore VA/1

- a) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga B:80% / A:18% / IN:2%, ndryshojnë në B:76% / A:19% / IE+S:3% / IN:2%.*
- b) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*



22. Në njësinë strukturore VA/3

- a) *Kufiri i njësisë strukturore ndryshon sipërfaqen nga 293001.32 m², në 290472.21 m², si pasojë e miratimit të kufirit të zonës së rindërtimit Kombinat.*
- b) *Saktësohen poligonet e përdorimit të tokës, pa ndryshime në %.*
- c) *Koordinatat e njësisë strukturore paraqiten në Shtojcën V.*



KREU III

NDRYSHIME NË ‘HARTËN E NJËSIVE STRUKTUREORE’, NË ‘HARTËN E PËRDORIMIT TË TOKËS’, NË ‘HARTËN E RRJETIT RRUGOR TË PROPOZUAR SIPAS KATEGORIVE TË KODIT RRUGOR’, NË ‘HARTËN E PYLLIT ORBITAL TË TIRANËS’ DHE NË TABELAT PARAMETRIKE TË NJËSIVE STRUKTUREORE PËR SHKAK TË MOSPËRPUTHJEVE TË PËRCAKTIMEVE NË DOKUMENTIN E PLANIFIKIMIT ME GJENDJEN FAKTIKE TË ZHVILLIMEVE NË TERRITOR

Në *‘Hartën e njësive strukturore’*, në *‘Hartën e përdorimit të tokës’*, në *‘Hartën e rrjetit rrugor të propozuar sipas kategorive të kodit rrugor’*, në *‘Hartën e Pyllit Orbital të Tiranës’* dhe në tabelat parametrike të njësive strukturore, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon. Këto ndryshime bazohen në Vendimin nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, neni 2, pika 38.

Paraqitja grafike e ndryshimeve do të bëhet sipas imazheve në *Shtojcën II* dhe koordinatave në *Shtojcën V* të këtij dokumenti.

I. Reflektimi i ndryshimit të kufirit administrativ dhe territorial të Bashkisë Tiranë

